

20140441306

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13 dhe 187/13), neni 10 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 11 paragrafi (4) ndryshon si vijon:

“(4) Ministri i Kulturës për çështje nga kompetenca e Ministrisë së Kulturës ose për realizimin e projekteve të caktuara me interes nacional në kulturë, mund të formojë edhe trupa këshillëdhënës dhe të angazhojë bashkëpunëtorë të jashtëm në pajtim me ligjin.”

Neni 3

Në nenin 11-a pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

“(5) Amasadorët e kulturës janë të detyruar që çdo vit më së voni deri më 31 janar në vitin rrjedhës të dorëzojnë raport në Ministrinë e Kulturës për vitin paraprak për aktivitetet e realizuara për promovim dhe afirmim të kulturës së Republikës së Maqedonisë.”

Neni 4

Në nenin 16 paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (2).

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (3) fjalët: “paragrafi (3) zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (2)”.

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (4) fjalët: “paragrafi (4)” zëvendësohet me fjalët: “paragrafi (3)”.

Neni 5

Në nenin 28 paragrafi (2) pika 7 shlyhet.

Pikat 8 dhe 9 bëhen pika 7 dhe 8.

Paragrafët (3) dhe (4) shlyhen.

Neni 6

Në nenin 29 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“(1) Për zgjedhjen e drejtorit të institucionit nacional nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji shpallet konkurs publik në tri gazeta ditore që botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.”

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“(2) Drejtori nga paragrafi (1) i këtij neni zgjidhet në kohë prej katër vitesh dhe mund të rizgjidhet .”

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

“(3) Drejtor i institucionit nacional nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji mund të zgjidhet person i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës, ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtari ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas STEK ose ka përfunduar shkallën VII/1 të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;

4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në sferën e kulturës dhe

5) posedon një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare vijuese ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë ;
- BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
- APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe

6) ka dhënë test psikologjik dhe test për integritet."

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (4) fjala "drejtorë" zëvendësohet me fjalën "drejtor".

Neni 7

Në nenin 30 paragrafi (1) në fjalinë e parë dhe të dytë fjala "konkursi" zëvendësohet me fjalët: "shpallja publike".

Neni 8

Paragrafi 31 ndryshon si vijon:

"Neni 31

Drejtori i institucionit nacional, në pajtim me statutin, mundet me lidhje të marrëveshjes të angazhojë person të jashtëm si këshilltar artistik në pajtim me ligjin, në korniza të mjeteve të miratuara për punën e institucionit."

Neni 9

Pas nenit 31 shtohen dy nene të reja 31-a dhe 31 – b, si vijojnë:

"Neni 31-a

(1) Ministria e Kulturës, në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes së drejtorit, me drejtorin e institucionit nacional lidh marrëveshje menaxhuese me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e Ministrisë së Kulturës dhe të drejtorit (në tekstin e mëtejshëm : marrëveshja menaxhuese). Me lidhjen e marrëveshjes menaxhuese, drejtori themelon marrëdhënie pune në institucionin nacional në kohë të caktuar, për kohëzgjatjen e mandatit të tij.

(2) Gjatë lidhjes së marrëveshjes menaxhuese merret parasysh lloji i institucionit nacional, statusi i institucionit amë, numri i të punësuarve, nevojat e institucionit nacional dhe veprimtaria e institucionit nacional.

(3) Marrëveshja menaxhuese përmban tregues për sukses që duhet t'i realizojë drejtori, shpërblime për sukses në punë të institucionit dhe dënim kontraktues për mosrespektim të marrëveshjes menaxhuese nga ana e drejtorit, të cilën do ta caktojë ministri i Kulturës në lartësi prej 50 deri në 100 euro në kundërvlerë në denarë ose në lartësi prej 50 deri në 100 euro në kundërvlerë në denarë për periudhë prej një deri në gjashtë muaj.

(4) Me marrëveshjen menaxhuese përcaktohet edhe lartësia e rrogës së drejtorit të institucionit nacional.

(5) Rrogën e drejtorit të institucionit nacional e përcakton ministri i Kulturës, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e varësisht nga lloji i institucionit nacional, statusi i institucionit amë, numri i të punësuarve, nevojat e institucionit nacional, ndërlikueshmëria e punës dhe veprimtaria e institucionit nacional, lartësia e rrogës përcaktohet në koeficientin nga 2, 4058 deri në 5, 2154. Vlerën e koeficientit e përcakton ministri i Kulturës, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 31-b

(1) Drejtori i institucionit nacional është i detyruar që në çdo gjashtë muaj te ministri i kulturës të dorëzojë raport për punën financiare të institucionit nacional dhe raport për realizimin e programit vjetor për punën e institucionit nacional.

(2) Nëse gjatë kontrollit të raporteve nga paragrafi (1) i këtij neni nga ana e Ministrisë së Kulturës konstatohen mangësi dhe/ose humbje në punën financiare, përkatësisht nëse përcaktohet se programi vjetor për punën e institucionit nacional nuk zbatohet në pajtim me dinamikën e përcaktuar dhe në korniza të mjeteve të caktuara, drejtori është i detyruar t'i evitojë mangësitë dhe humbjet në gjashtë mujat e ardhshëm.

(3) Nëse edhe pas skadimit të gjashtë muajve drejtori nuk i eviton mangësitë e caktuara dhe në atë periudhë përsëri ka mangësi dhe/ose humbje në punën financiare dhe në realizimin e programit vjetor për punën e institucionit nacional, të cilat janë rezultat i punës së drejtorit, ministri i Kulturës do ta shkarkojë drejtorin dhe do të emëroj ushtrues detyre të drejtorit në pajtim me nenin 34 të këtij ligji."

Neni 10

Në nenin 33 paragrafi (3) shlyhet.

Neni 11

Në nenin 36 paragrafi (1) pika 5 fjalët: "dhe rregullorja për rroga" shlyhen.

Në pikën 9 lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 9 shtohen tri pika të reja 10, 11 dhe 12, si vijojnë:

"10. e ndjek realizimin e programit vjetor për punën e institucionit nacional;

11. miraton akte për audicion dhe riaudicion;

12. një herë në vit dorëzon raport për punën e vet në Ministrinë e Kulturës dhe"

Pika 10 bëhet pika 13.

Neni 12

Kapitulli i katërt dhe nenet 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69 dhe 70 ndryshohen si vijojnë:

"Kapitulli i katërt

FINANCIMI I INTERESIT NACIONAL NË KULTURË

Neni 60

(1) Financimi i interesit nacional në kulturë kryhet me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në pajtim me këtë ligj.

(2) Ministria e Kulturës me mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni e financo punën e institucioneve nacionale në kulturë dhe merr pjesë në financimin e projekteve me interes nacional në kulturë të personave tjerë juridikë dhe fizikë.

(3) Mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë shfrytëzohen dhe për afirmimin dhe përparimin e kulturës së të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 61

(1) Për realizimin e interesit nacional në kulturë, në pajtim me Strategjinë nacionale, Ministria e Kulturës miraton plan vjetor për realizimin e interesit nacional në kulturë (në tekstin e mëtejme: plani vjetor).

(2) Plan vjetor miratohet në korrik në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(3) Me planin vjetor përcaktohen orientimet e përgjithshme për realizimin e interesit nacional në kulturë për vitin e ardhshëm që kanë të bëjnë posaçërisht me:

- nxitje të krijimtarisë artistike,
 - qasje të krijimtaria artistike,
 - mbrojtjen e vazhdueshme të trashëgimisë kulturore të tundshme dhe të patundshme dhe promovimin e saj,
 - kultivimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore,
 - sigurimin e kushteve për zhvillim të barabartë kulturor,
 - realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kulturë,
 - plotësimin e nevojave kulturore të bashkësive në Republikën e Maqedonisë,
 - digjitalizim të trashëgimisë kulturore dhe të krijimtarisë artistike bashkëkohore,
 - futjen e teknologjive të reja në institucionet nga sfera e kulturës,
 - mbështetje të aktiviteteve kulturore të të rinjëve,
 - aktivitete kulturore të sektorit të pavarur të kulturës,
 - zhvillim të industrive kreative dhe
 - qasje të kultura të personave me nevoja të posaçme.
- (4) Plani vjetor shpallet në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës.

Neni 62

(1) Minsitria e Kulturës , në shtator të vitit rrjedhës për vitin e ardhëshëm shpall konkurs vjetor për financimin e projekteve me interes nacional sipas sferave dhe aktiviteteve të caktuara nga kultura (në tekst të mëtejme: konkurse vjetore).

(2) Konkursët vjetore nga paragrafi (1) i këtij neni përmbajnë:

- kushte për pjesëmarrje në konkurs ,
- kriterë dhe masa në bazë të cilave do të kryhet vlerësim i projektit,
- përqindjen e pjesëmarrjes së Ministrisë së Kulturës në financimin e projekteve,
- afatin për dorëzim të fletëparaqitjeve dhe
- informata tjera.

(3) Konkursët vjetore nga paragrafi (1) i këtij neni shpallen në mjetet për informim publik dhe zgjasin së paku 30 ditë nga dita e shpalljes. Konkursët vjetore shpallen së paku në një nga gazeta që botohet në gjuhën maqedonase dhe në një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Neni 63

(1) Vlerësim të fletëparaqitjeve për financim të projekteve nga konkursët vjetore nga neni 62 paragrafi (1) të këtij ligji kryejnë komisionet profesionale, përkatësisht bashkëpunëtorët e jashtëm të minsitrit të Kulturës nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji.

(2) Bartësi i projektit, përkatësisht autori i projektit dhe pjesëmarrës në realizimin e projektit me të cilin ka konkurruar në konkursët vjetore nga neni 62 të këtij ligji nuk mund të emërohet për anëtar të komisionit, përkatësisht për bashkëpunëtor të jashtëm.

(3) Kryetari dhe anëtarët e komisioneve, përkatësisht bashkëpunëtorët e jashtëm dorëzojnë deklaratë me shkrim se nuk kanë konflikt të interesave lidhur me fletëparaqitjet e arritura në konkurse vjetore nga neni 62 paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Komisionet dhe bashkëpunëtorët e jashtëm nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzojnë te ministri i Kulturës raport me propozime për projektet që duhet të zgjidhen, shumën e mjeteve të nevojshme dhe projektet që do të refuzohen për shkaqe të arsyeshme për refuzimin e tyre.

Neni 64

(1) Ministria e Kuluturës, gjatë vitit mund të shpallë edhe konkurse tjera për financimin e projekteve me interes nacional si konkurs për: blerjen e publikimeve, blerjen e materialeve muzeore, veprave artistike dhe muzikore, përkthime të veprave të autorëve nga Republika e Maqedonisë në gjuhë të huaja, bursa të kuadrove deficitarë në kulturë, zhvillim të industrive

kreative, zhvillim të barabartë kulturor dhe për realizim të manifestimeve dhe aktiviteteve në vend dhe jashtë vendit që janë me interes nacional në kulturë.

(2) Në konkurse nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e neneve 62 dhe 63 të këtij ligji.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, Ministria e Kulturës mund të ndajë mjete për realizimin e projekteve me interes nacional nga sfera e bashkëpunimit ndërkombëtar kulturor ose nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të cilat për shkaqe objektive nuk kanë mundur të dorëzohen në konkurset e Ministrisë së Kulturës për vitin rrjedhës.

Neni 65

(1) Ministri i Kulturës, me propozim të komisioneve, përkatësisht bashkëpunëtorëve të jashtëm nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji, në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, vendos për zgjedhje të projekteve me interes nacional në kulturë sipas konkurseve vjetore nga neni 62 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Ministri i Kulturës, me propozim të komisioneve, përkatësisht bashkëpunëtorëve të jashtëm nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji, në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të konkurseve nga neni 64 paragrafi (1) të këtij ligji, vendos për zgjedhje të projekteve me interes nacional në kulturë sipas konkurseve nga neni 64 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Aktvendimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni përmbajnë: të dhëna për projektet që janë zgjedhur në konkurs dhe të dhëna për projektet që janë refuzuar në konkurs.

(4) Rezultatet e konkurseve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni shpallen në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës.

(5) Kundër aktvendimeve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh për Komisionin Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(6) Ankesa nuk e prolongon zbatimin.

Neni 66

(1) Projektet e zgjedhura të konkurseve vjetore nga neni 62 paragrafi (1) të këtij ligji dhe të konkurseve nga neni 64 paragrafi (1) të këtij ligji duhet të realizohen deri në fundin e vitit rrjedhës.

(2) Nëse projekti nuk përfundon në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, bartësi i projektit është i detyruar që t'ia kthejë Ministrisë së Kulturës mjetet e marra në konkurs.

(3) Nëse bartësi i projektit nuk i kthen mjetet e ndara nga Ministria e Kulturës, Ministria e Kulturës do të ngritë procedurë para gjykatës kompetente për kthimin e mjeteve me kamatë ndëshkuese ligjore në pajtim me ligjin.

(4) Në rastin nga paragrafi (3) të këtij neni shfrytëzuesi nuk ka të drejtë të marrë pjesë në konkurs të Ministrisë së Kulturës në tre vitet e ardhëshme.

Neni 67

(1) Subjektet projektet e të cilave janë zgjedhur në konkurset vjetore nga neni 62 paragrafi (1) dhe konkurset nga neni 64 paragrafi (1) të këtij ligji, (në tekst të mëtejme: shfrytëzuesit), pas marrjes së aktvendimeve nga neni 65 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, me Ministrinë e Kulturës lidhin marrëveshje për financimin e projektit me interes nacional në kulturë.

(2) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen: projekti për të cilin ndahen mjete, lartësia e mjeteve, mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, dinamika dhe afati për realizimin e projektit, dorëzimi i raporteve në lidhje me projektin, kontrolli dhe mbikëqyrja ndaj shfrytëzimit me dedikim të mjeteve, sanksionet për mosplotësimin e detyrave nga marrëveshja dhe çështje tjera me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrat e shfrytëzuesve. Në marrëveshje zbatohen dispozitat nga sfera e marrëdhënieve obliguese.

Neni 68

(1) Shfrytëzuesit janë të detyruar që me dedikim t'i shfrytëzojnë mjetet e marra nga Ministria e Kulturës.

(2) Shfrytëzuesit janë të detyruar që t'i përmbahen planit operativ dhe financiar për realizim të projektit që janë pjesë përbërëse e marrëveshjes nga neni 67 të këtij ligji. Shfrytëzuesit janë të detyruar që pas çdo faze nga realizimi i projektit në Ministrinë e Kulturës të dorëzojnë raporte për mjetet e shpenzuara që është kusht për marrjen e mjeteve nga Ministria e Kulturës për fazën e ardhëshme të realizimit të projektit.

(3) Shfrytëzuesit në afat prej një muaji , duke llogaritur nga dita e përfundimit të projektit, janë të detyruar që në Minsitrinë e Kulturës të dorëzojnë raport për realizimin e projektit i cili përmban: paraqitje narrative për realizimin e projektit, specifikim për mjetet e përgjithshme të shpenzuara për realizimin e projektit, marrëveshje, llogari, fatura, plan përfundimtar financiar me të gjitha shumat e mjeteve dhe burimeve të shpenzuara të financimit.

Neni 69

(1) Ministria e Kulturës e ndjek realizimin e marrëveshjeve të lidhura nga neni 67 të këtij ligji dhe kryen kontroll dhe mbikëqyrje ndaj realizimit të tyre.

(2) Shfrytëzuesit janë të detyruar të mundësojnë kontroll dhe mbikëqyrje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Nëse me raport nga kontrolli dhe mbikëqyrja e kryer përcaktohet se mjetet e ndara shfrytëzohen në kundërshtim me marrëveshjen nga neni 67 të këtij ligji, përkatësisht se shfrytëzuesit nuk i përmbahen afateve dhe detyrave të përcaktuara në marrëveshje, Ministria e Kulturës njëanshëm do ta prishë marrëveshjen, do ta ndërprejë financimin e mëtejshëm të projektit dhe do të ngritë procedurë para gjykatës kompetente për kthimin e mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës me kamatë ndëshkuese ligjore në pajtim me ligjin.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) të këtij neni, shfrytëzuesit nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs të Ministrisë së Kulturës në tre vitet e ardhëshme.

Neni 70

(1) Drejtori i institucionit nacional në qershor në vitin rrjedhës për vitin e ardhëshëm miraton projekt-program vjetor për punën e institucionit (në tekstin e mëtejshëm: projekt-programi vjetor) dhe e dorëzon për Ministrinë e Kulturës.

(2) Në projekt-programin vjetor paraqiten mjetet e nevojshme për: aktivitete programore, shpenzime operative të institucionit, rroga dhe kompensime tjera për të punësuarit dhe për bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët do të angazhohen për realizimin e programit, shpenzimet materiale dhe shpenzimet për mirëmbajtje investuese, sigurim, adaptim dhe blerje të pajisjes për institucionin.

(3) Në projekt-programin vjetor paraqiten mjetet e planifikuara që të realizohen në baza tjera si të ardhura personale, të ardhura nga shërbime dhe donacione.

(4) Projekt-programi vjetor përmban projekte me specifikim të shpenzimeve sipas dedikimeve dhe aktiviteteve.

(5) Për projektet e përfshira në projekt-programin vjetor vendos ministri i Kulturës me propozim të komisioneve, përkatësisht bashkëpunëtorëve të jashtëm nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji, në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(6) Me përjashtim nga paragrafi (5) të këtij neni, për institucione të caktuara nacionale të cilat në vitin e kaluar kanë treguar rezultate të jashtëzakonshme në punë, ministri i Kulturës në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë vendos vetëm për lartësinë e mjeteve financiare për punë të institucionit nacional, e jo edhe për projektet e përfshira në projekt-programin vjetor.

(7) Programin vjetor për punë të institucionit nacional e miraton drejtori i institucionit, me pëlqim paraprak të këshillit drejtues në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të aktvendimeve nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni."

Neni 13

Pas nenit 70 shtohen katër nene të reja 70-a, 70-b, 70-v dhe 70-g, si vijojnë:

"Neni 70-a

(1) Ministria e Kulturës dhe drejtori i institucionit nacional lidhin marrëveshje për financimin e programit vjetor për punë të institucionit nacional.

(2) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen: mënyra e realizimit të programit vjetor për punën e institucionit nacional dhe plani financiar për realizimin e programit, dorëzimi i raporteve, mbikëqyrja ndaj shfrytëzimit të dedikuar të mjeteve dhe çështje tjera me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrat e institucionit nacional. Në marrëveshje zbatohen dispozitat nga sfera e marrëdhënieve obliguese.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni në rastet nga neni 70 paragrafi (6) të këtij ligji, në marrëveshje përfshihen edhe projektet me shumën e mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e të njëjtave.

(4) Institucioni nacional është i detyruar që me dedikim t'i shfrytëzojë mjetet e marra nga Ministria e Kulturës dhe ta realizojë programin vjetor për punën e institucionit nacional në korniza të mjeteve të siguruar nga Ministria e Kulturës dhe nga burime tjera.

(5) Ministria e Kulturës kryen kontroll dhe mbikëqyrje ndaj shfrytëzimit me dedikim të mjeteve nga marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Drejtori i institucionit nacional është përgjegjës për realizimin e marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për realizimin e programit vjetor për punën e institucionit nacional dhe nuk guxon të marrë obligime financiare ndaj mjeteve të siguruar.

(7) Nëse me kontroll dhe mbikëqyrje nga Ministria e Kulturës konstatohet se drejtori ka marrë obligime ndaj mjeteve të siguruar, e nuk i ka siguruar nga burime tjera të mjeteve, drejtori do të përgjigjet për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar në pajtim me Kodin penal.

Neni 70-b

(1) Institucionet nacionale janë të detyruara që në ueb faqen e vet t'i shpallin projektet që do t'i realizojnë në vitin rrjedhës.

(2) institucionet nacionale në tremujorin e parë të vitit rrjedhës për vitin e kaluar dorëzojnë raport në Ministrinë e Kulturës për realizimin e programit vjetor për punë të institucionit nacional nga neni 70-a paragrafi (7) të këtij ligji, i cili përmban: paraqitje narrative për realizimin e programit, specifikim për mjetet e përgjithshme të shpenzuara, marrëveshje, llogari, fatura dhe plan përfundimtar financiar me të gjitha shumatat e mjeteve të shpenzuara dhe burime të finansimit.

(3) Institucionet nacionale në ueb faqen e vet, në tremujorin e parë në vitin rrjedhës për vitin paraprak, shpallin raport për realizimin e programit vjetor për punën e institucionit nacional.

Neni 70-v

(1) Ministria e Kulturës, me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, miraton program vjetor për ndërtimin e objekteve të reja dhe për rikonstruksion, sanim dhe adaptim të objekteve ekzistuese që i shfrytëzojnë institucionet nacionale (në tekstin e mëtejme: programi vjetor për investime në kulturë). Programi vjetor për investime në kulturë miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Programin vjetor për investime në kulturë e zbaton Ministria e Kulturës në kuadër të mjeteve të siguruar në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për atë dedikim.

(3) Programi vjetor për investime në kulturë shpallet në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës.

Neni 70-g

(1) Ministria për kulturë deri në fund të marsit të vitit vijues, miraton raport vjetor për punë të Ministrisë së kulturës për vitin paraprak dhe e shpall në ueb faqen e Ministrisë së kulturës.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni përmban të dhëna për realizimin e projekteve që janë të financuara nga Ministria e Kulturës sipas konkurseve, për programet e institucioneve nacionale, për projektet nga programi vjetor për investime në kulturë dhe për aktivitete tjera nga kompetenca e Ministrisë së Kulturës.

(3) Ministria e Kulturës, mund të organizojë edhe forma tjera për prezantimin e projekteve të realizuara të financuara nga Ministria e Kulturës me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.”

Neni 14

Neni 71 shlyhet.

Neni 15

Në Kapitullin pesë , titulli i Nënpjesës 3 dhe neni 76 ndryshohen si vijojnë:

“TË DREJTA NGA MARRËDHËNIA E PUNËS NË INSTITUCIONIN PUBLIK NGA SFERA E KULTURËS

Neni 76

(1) Në institucionin publik nga sfera e kulturës vendet e punës së të punësuarve grupohen në grupe dhe nëngrupe në pajtim me Ligjin për punësim në sektorin publik.

(2) Të punësuarit në institucionet publike nga sfera e kulturës të cilët kryejnë punë nga natyra administrative për realizim të veprimtarive në kulturë kanë status të nëpunësve administrativë.

(3) Për të punësuarit nga paragrafi (2) i këtij neni kategoritë, nivelet dhe titujt përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(4) Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin , evidencën, punësimin, përparimin, përsosjen profesionale dhe aftësimin, matjen e efektit dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës të nëpunësve administrativë në institucionet publike nga sfera e kulturës zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë.”

Neni 16

Pas nenit 76 shtohen tetë nene të reja 76-a, 76-b, 76-v, 76-g, 76-d 76-gj 76-e dhe 76-z si vijojnë:

“Neni 76-a

(1) Të punësuarit në institucionet publike nga sfera e kulturës, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë dhe për ta zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

Kategoria A - artistë,

- Kategoria B- bashkëpunëtorë artistikë për përgatitjen e veprave skenike dhe veprave skenike muzikore,

- Kategoria V- punëtorë profesionalë skenikë,

- Kategoria G- bashkëpunëtorë profesionalë në veprimtari nga sfera e kulturës,

- Kategoria D - bashkëpunëtorë profesionalë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,

- Kategoria GJ - bashkëpunëtorë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 76-b

(1) Në korniza të Kategorisë A përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë:

- Niveli A1: artistë të parë – lojtar i parë i baletit, aktor i parë, solist i parë i operës, dirigjent e të tjerë,

- Niveli A2: Artist - mjeshtër koncerti e të tjerë,

- Niveli A3: artistë grupi i parë- solist të shquar të operës, lojtarë të shquar të baletit - solistë, aktorë grupi i parë, grupi i parë i instrumenteve me frymë (trumbeta, briri, trumboni, fagoti, flauta, klarineti, oboa), udhëheqës i grupit të violinistëve (violina e dytë, viola, violonçelo dhe kontrabasi) zëvendësmjeshtër i koncertit, harfa, tollombazi, lojtar i parë në IN Tanec dhe të tjerë.

- Niveli A4: artistë grupi i dytë – solist opere bartës i roleve të mesme, lojtar baleti bartës i roleve të mesme, aktorë grupi i dytë, instrumentist i tretë me frymë (trumpetë me piston, briri, trumboni, klarineti bas, klarineti c, oboa e tretë me brirë anglez, flauta e tretë me pikolo, fagoti, kontrafagoti), tuba, instrumente me goditje, zëvendës i grupit të instrumentave me tela (violina e dytë, viola, violonçelo dhe kontrabasi), lojtarë të shquar të rendit të parë – solist dhe këngëtar i shquar rendit të parë – solist në IN Tanec, koreptitor në operë/balet, mjeshtër kori, pedagog repetitor dhe të tjerë.

- Niveli A5: artistë të grupit të tretë - solist të operës bartës të roleve me pjesë, lojtarë baleti – bartës të roleve me pjesë, grupi i dytë i instrumentistëve me frymë (oboa, flauta, fagoti, klarineti, korna, flauta e dytë me pikolo), violina e parë tuti , lojtar/këngëtar më i vjetër - solist në IN Tanec, aktor grupi i tretë, asistent mjeshtër kori dhe të tjerë,

- Niveli A6: artistë grupi i katërt – aktor grupi i katërt , instrumentistëve me frymë tuti, anëtarë të korit, anëtarë në ansamblin e baletit, lojtar/këngëtar në IN Tanec dhe të tjerë.

(2) Të punësuarit në Kategorinë A duhet të kenë së paku 240 kredi të marra sipas STEK ose të përfunduar shkallën VII/1 ose të përfunduar shkollën e mesme të baletit përkatësisht shkollën e mesme të muzikës.

(3) Të punësuarit nga Kategoria A duhet të kenë përvojë pune si vijon:

- për nivelet A1 dhe A2; së paku pesë vjet përvojë pune në profesion,

- për nivelin A3: së paku tre vjet përvojë pune në profesion,

- për nivelin A4: së paku dy vjet përvojë pune dhe

- për nivelet A5 dhe A6; deri në një vit përvojë pune.

Neni 76-v

(1) Në korniza të Kategorisë B përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë:

- Niveli B1: bashkëpunëtorë artistikë për përgaditjen e veprave skenike dhe skenike muzikore, dramaturg, regjisor, skenograf, kostimograf, aktor me kukulla, skulptor akademik, piktor kompozitor, koreograf dhe të tjera,

- Niveli B2: bashkëpunëtorë artistikë për përgaditjen e veprave skenike dhe skenike muzikore, asistent dramaturg, regjisor, skenograf, kostimograf, ispicient, aktor me kukulla, skulptor akademik, piktor, kompozitor, koreograf dhe të tjera.

(2) Të punësuarit në Kategorinë B duhet të kenë së paku 240 kredi të marra sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1.

(3) Të punësuarit nga Kategoria B duhet të kenë përvojë pune si vijon:

- për nivelin B1: së paku pesë vjetë përvojë pune në profesion,

- për nivelin B2: së paku një vjet përvojë pune në profesion,

(4) Të punësuarit në Kategorinë B duhet të posedojnë certifikatë të pranuar ndërkombëtare nga testues zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë, ose vërtetim nga institucioni ndërkombëtar për njohjen e një nga tri gjuhët më të përdorura në Bashkimin

Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të nivelit A1 (A1) të CEFR (CERF), përkatësisht BULATS ose Aptis ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gete Certifikatë.

Neni 76-g

(1) Në korniza të Kategorisë V përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë:

- Niveli V1: udhëheqës i skenës,
- Niveli V2: punëtor profesionalë të skenës inxhinierë për skenë dhe të tjerë.

(2) Të punësuarit në Kategorinë V duhet të kenë së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1 .

(3) Të punësuarit nga Kategoria V duhet të kenë përvojë pune si vijon:

- për nivelin V1: së paku pesë vjetë përvojë pune në profesion,
- për nivelin V2: së paku një vit përvojë pune në profesion,

(4) Të punësuarit në Kategorinë V duhet të posedojnë certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyre dhe certifikatë të pranuar ndërkombëtare të dhënë nga testues zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë, ose vërtetim nga institucioni ndërkombëtar për njohjen e një nga tri gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të nivelit A1 (A1) CEFR (CERF), përkatësisht BULATS ose Aptis ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gete Certifikatë.

Neni 76-d

(1) Në korniza të Kategorisë G përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë:

- Niveli G1: udhëheqës artistik dhe programor dhe të tjerë,
- Niveli G2: bashkëpunëtor profesional në veprimtari nga sfera e kulturës për veprimtari skenike muzikore, për veprimtari dramatike, veprimtarinë botuese, për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë dhe për veprimtarinë e filmit, për bashkëpunimin ndërkombëtar, për arkiv muzikor dhe të tjerë,
- Niveli G3: bashkëpunëtorë në veprimtari nga sfera e kulturës për veprimtari skenike muzikore, letrare, për veprimtari dramatike, veprimtari botuese, për arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë dhe për veprimtarinë e filmit, për bashkëpunim ndërkombëtar, për arkiv muzikor, sufler, trajnues për ushtrime të kondicionit, koordinator të depove dhe të tjerë.

(2) Të punësuarit në Kategorinë G duhet të kenë së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1 ose të përfunduar arsimin e mesëm.

(3) Të punësuarit nga Kategoria G duhet të kenë përvojë pune si vijon:

- për nivelet G1 dhe G2; së paku pesë vjet përvojë pune në profesion,
- për nivelin G3: përvojë pune deri në një vit.

(4) Të punësuarit në Kategorinë G duhet të posedojnë certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë si dhe certifikatë të pranuar ndërkombëtare të dhënë nga testues zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë, ose vërtetim nga institucioni ndërkombëtar për njohjen e një nga tri gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të nivelit A1 (A1) CEFR (CERF), përkatësisht BULATS ose Aptis ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gete Certifikatë .

Neni 76-gj

(1) Në korniza të Kategorisë D përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë:

- Niveli D1: bashkëpunëtorë profesionalë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me titull të zgjedhur këshilltar – këshilltar bibliotekist, këshilltar kustos, këshilltar konservues, këshilltar dokumentator, këshilltar filmolog dhe të tjerë.

- Niveli D2: punëtorp profesionalp në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me titull të zgjedhur – bibliotekar i lartë, kustos i lartë, konservues i lartë, dokumentator i lartë, filolog i lartë dhe dhe të tjerë,

- Niveli D3: punëtorë profesionalë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore – bibliotekar, konservues, dokumentator, filolog, edukator, udhëheqës dhe të tjerë.

(2) Të punësuarit në Kategorinë D duhet të kenë së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1 .

(3) Të punësuarit nga Kategoria D duhet të kenë përvojë pune si vijon:

- për nivelin D1: së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion dhe arritjen e titullit profesional në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,

- për nivelin D2: së paku tre vjet përvojë pune në profesion dhe arritjen e titullit profesional në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,

- për nivelin D3: përvojë pune deri në një vit.

(4) Të punësuarit në Kategorinë D duhet të posedojnë certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyre si dhe certifikatë të pranuar ndërkombëtare të dhënë nga testues zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë, ose vërtetim nga institucioni ndërkombëtar për njohjen e një nga tri gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të nivelit A1 (A1) CEFR (CERF), përkatësisht BULATS ose Aptis ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gëte Certifikatë.

Neni 76-e

(1) Në korniza të Kategorisë GJ përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë:

- Niveli GJ1: bashkëpunëtorë profesionalë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore - laborant i lartë, teknik konservator i lartë, teknik dokumentator i lartë, preparues i pavarur, ndihmës i pavarur bibliotekar, teknik i lartë filmik dhe të tjerë,

- Niveli GJ2: bashkëpunëtorë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, laborant, teknik konservator, teknik dokumentator, preparues, ndihmës bibliotekar, teknik filmi dhe të tjerë.

(2) Të punësuarit në Kategorinë GJ duhet të kenë së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1 ose të përfunduar arsimin e mesëm.

(3) Të punësuarit nga Kategoria GJ duhet të kenë përvojë pune si vijon:

për nivelin GJ1: së paku dy vjet përvojë pune në profesion,

për nivelin GJ2: pa përvojë pune.

(4) Të punësuarit në Kategorinë GJ niveli GJ1 duhet të posedojnë certifikatë të pranuar ndërkombëtare nga testues zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë, ose vërtetim nga institucioni ndërkombëtar për njohjen e një nga tri gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të nivelit A1 (A1) CEFR (CERF), përkatësisht BULATS ose Aptis ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë ose, ose DELF, TCF, TEF ose Gëte Certifikatë.

Neni 76-zh

(1) Për të punësuarit në institucionet publike nga sfera e kulturës që kryejnë punë ndihmëse teknike dhe kanë status të personave teknikë ndihmës zbatohen dispozitat nga ky ligj, Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Për personat teknikë ndihmës përcaktohen këto nëngrupe:

- Nëngrupi 1: persona ndihmës teknik për mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjes,
- Nëngrupi 2: Persona teknik ndihmës për sigurimin e objekteve dhe pajisjes;
- Nëngrupi 3: Persona teknikë ndihmës për transport të personave dhe pajisjes; dhe
- Nëngrupi 5: persona tjerë ndihmës teknikë.

(3) Në korniza të Nëngrupit 1: persona ndihmës teknikë për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjes përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

1) Kategoria A - Mirëmbajtje e pajisjes:

- Niveli A1: teknikë për mirëmbajtje - teknikë (elektricitist, elektronist, makinerik, i ndërtimit, hortikulturor dhe veterinarik), ndriçues, manipulues i depos, kinooperator dhe të tjerë,
- Niveli A2: punëtorë përgjegjës të skenës- zdrukthtar, bravapunues, mjeshtër i ujësjelljes, marangoz, tapetier, përpunues i rekuizitave dhe të tjerë ,
- Niveli A3: punëtorë të skenës – zdrukthtar, bravapunues, marangoz, tapetier, dekorator dhe të tjerë.

2) Kategoria B- Mirëmbajtje e objekteve:

- Niveli B1: punëtorë për pranim të vizituesve në institucione – garderobier, shitës i biletave, shitës dhe të tjerë,
- Niveli B2: punëtorë për mirëmbajtjen e objekteve dhe për mirëmbajtjen e higjienës në objekte - haus-mjeshtër, portier, shtëpiar, magazinist dhe të tjerë.
- Niveli B3: higjienist, ndezës i nxemjes qendrore dhe të tjerë.

(4) Në korniza të Nëngrupit 2: persona ndihmës teknikë për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjes përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

1) Kategoria A:

- Niveli A1: punëtorë për sigurim të objekteve dhe punë tjera të ngjashme të lidhura me sigurimin dhe të tjera,
- Niveli A2: punëtor ndihmës për sigurim të objekteve dhe punë tjera të ngjashme të lidhura me sigurimin dhe të tjera.

(5) Në korniza të Nëngrupit 3: persona ndihmës teknikë për transport të personave dhe pajisjes përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

1) Kategoria A:

- Niveli A1: shofer dhe të tjerë

(6) Në korniza të Nëngrupit 5: personat tjerë ndihmës teknikë përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

1) Kategoria A:

- Niveli A1: punëtor të efekteve skenike vizuele të skenës- teknik për drita, teknik për ton, piktor dhe teknik piktor, piroteknik, kopjues i eksponatave dhe të tjerë,

2) Kategoria B:

- Niveli B1: punëtorë për krijim dhe mirëmbajtje të rekuizitës dhe funduseve të institucioneve artistike-skenike dhe për përgatitje të realizuesve-kapelpunues, rrbapqepës, frizer, maskues, shminkues, periker, rekuizues dhe të tjerë.

3) Kategoria V:

- Niveli V1: punëtor i përgjithshëm - ruajtës i shtazëve, larëse, lidhës librash, këpuctar dhe të tjerë.

(7) Të punësuarit në të gjitha kategoritë në Nëngrupet 1, 2, 3 dhe 5 duhet të kenë:

- për nivelet A1 dhe A2; së paku shkollimin e mesëm katërvjeçar përkatësisht shkollimin e mesëm trevjeçar;
- për nivelet B1 dhe B2; së paku shkollimin e mesëm katërvjeçar përkatësisht shkollimin e mesëm trevjeçar;
- për nivelet A3, B3 dhe V3: së paku shkollimin fillor.”

Neni 17

Neni 77 ndryshon si vijon:

“Neni 77

(1) Drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës, me mendim paraprak të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe pëlqim paraprak nga Ministria e Kulturës miraton plan vjetor për punësimin e nëpunësve administrativë, dhënësve të shërbimeve publike në kulturë dhe të personave ndihmës teknikë për vitin e ardhëshëm, në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

(2) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni gjatë vitit me të cilin ka të bëjë mund të ndryshohet vetëm me pëlqim të marrë paraprakisht nga Ministria e Kulturës."

Neni 18

Pas nenit 77 shtohen 14 nene të reja 77-a, 77-b, 77-v, 77-g, 77-d, 77-gj, 77-e, 77-z, 77-z, 77-z, 77-i, 77-j, 77-k dhe 77-ll, si vijojnë:

“Neni 77-a

(1) Mbushja e vendeve të punës për dhënësit e shërbimeve publike në kulturë në institucionet publike nga sfera e kulturës kryhet përmes zbatimit të procedurës për:

- punësim,
- avancim dhe
- mobilitet përmes sistemimit ose marrjes.

(2) Procedura për punësim fillon me shpalljen e konkursit publik, me ç'rast në procedurë transparente, të drejtë dhe konkurruese të seleksionimit zgjidhet kandidati më i mirë për vendin e punës dhe i njëjti themelon marrëdhënie pune në institucionin publik nga sfera e kulturës.

(3) Procedura për avancim fillon me shpalljen e konkursit intern, me ç'rast në procedurë transparente, të drejtë dhe konkurruese të seleksionimit zgjidhet kandidati më i mirë nga rradha e të punësuarve në institucionin publik nga sfera e kulturës dhe i njëjti kalon në vend pune në nivel më të lartë.

(4) Procedura për mobilitet zbatohet në procedurë transparente dhe të drejtë të sistemimit, përkatësisht marrjes së të punësuarit në vendin e punës në nivel të njëjtë në institucionin e njëjtë ose tjetër në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

(5) Procedurat për plotësimin e vendeve të punës nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen me pëlqim të marrë paraprakisht për mjete financiare të siguruara nga Ministria e Financave.

Neni 77-b

(1) Për plotësimin e vendit të punës për dhënësit e shërbimeve publike në kulturë, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- të jetë i moshës madhire,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

(2) Përveç kushteve të përgjithshme për plotësimin e vendit të punës për dhënësit e shërbimeve publike në kulturë nga paragrafi (1) i këtij neni, kandidati duhet të plotësojë edhe kushte të posaçme të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës në institucionin publik nga sfera e kulturës, si vijon:

- të ketë kualifikime përkatëse profesionale të nevojshme për vendin e punës,
- të ketë përvojë përkatëse pune të nevojshme për vendin e punës dhe
- të posedojë kompetenca tjera të posaçme të punës të nevojshme për vendin e punës, në pajtim me aktin për sistematizim të vendeve të punës dhe marrëveshjen kolektive.

Neni 77-v

(1) Për fillimin e procedurës për punësim të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë, drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës në pajtim me planin vjetor për punësim në institucionin publik merr vendim për shpalljen e konkursit publik.

(2) Marrëdhënie pune për Kategorinë A – artistë themelohet për periudhë deri në pesë vjet, e për dhënësit tjerë të shërbimeve publike në kulturë marrëdhënie pune themelohet në kohë të pacaktuar, përveç në raste të përcaktuara me ligj.

Neni 77-g

(1) Konkursi publik për punësim shpallet në ueb faqen e institucionit publik nga sfera e kulturës dhe në së paku në tri gazeta ditore nga të cilat së paku në njërin nga gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(2) Në konkursin publik shënohet kategoria, niveli dhe kushtet për plotësimin e vendit të punës.

(3) Afati për paraqitje në konkursin publik nuk mund të jetë më i shkurt se 15 ditë nga dita e shpalljes së tij në gazetata ditore.

Neni 77-d

Kandidatët për punësim dorëzojnë në institucionin publik nga sfera e kulturës fletëparaqitje dhe dëshmi se i plotësojnë kushtet nga konkursi publik.

Neni 77-gj

(1) Drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës me aktvendim formon Komisioni për procedurë për punësim.

(2) Komisioni për procedurë për punësim është i përbërë nga tre të punësuar udhëheqës si vijon: kryetari dhe dy anëtarë, si dhe zëvendësit e tyre.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni Komisioni për procedurë për punësim të artistit është i përbërë prej pesë anëtarëve, një nga radhët e artistëve të shquar nga Republika e Maqedonisë, kurse katër nga jashtë.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, në institucionin publik të ri të themeluar nga sfera e kulturës në të cilin nuk ka të punësuar nga sfera e kulturës ose në institucionin në të cilin nuk ka persona të punësuar udhëheqës, anëtarët e Komisionit për procedurë për punësim përcaktohen nga Ministria e Kulturës.

Neni 77-e

(1) Procedura për seleksionim për punësim përbëhet nga seleksionimi administrativ për kontrollin e autenticitetit të të dhënave të dorëzuara dhe dëshmive të dorëzuara në konkursin publik dhe në intervistë.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni procedura për seleksionim për punësim të artistëve përbëhet nga kontrolli i autenticitetit të të dhënave të dorëzuara dhe dëshmive të dorëzuara në konkursin publik dhe zbatimin e procedurës për audicion.

(3) Kandidatët të cilët me sukses e kanë kaluar procedurën e autenticitetit të dëshmive kanë të drejtë të vazhdojnë në intervistë përkatësisht në audicion.

(4) Në intervistë përmes pyetjeve kontrollohen kompetencat e nevojshme për kategorinë dhe nivelin të cilin i takon vendi i punës. Në audicion kontrollohen aftësitë artistike të kandidatit.

(5) Në afat prej tri ditësh Komisioni përgatit dhe te drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës dorëzon propozim kandidat.

Neni 77-zh

(1) Drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës në afat prej pesë ditësh nga dita e marrjes së propozimit nga neni 77–e paragrafi (5) i këtij ligji, është i detyruar të marrë vendim për zgjedhje.

(2) Vendimi për zgjedhje u dorëzohet kandidatëve dhe shpallet në ueb faqen dhe në tabelën e shpalljeve të institucionit publik nga sfera e kulturës.

(3) Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni kandidati i pakënaqur ka të drejtë në afat prej tetë ditësh të parashtojë ankesë në Këshillin Drejtues të institucionit publik nga sfera e kulturës.

Neni 77-z

(1) Në afat prej pesë ditësh nga përfundimi i vendimit për zgjedhje, drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës, merr aktvendim për punësim dhe me kandidatin e zgjedhur lidh marrëveshje për punësim.

(2) Kandidatit të zgjedhur i dorëzohet aktvendimi, përkatësisht marrëveshja, i sigurohet qasja te aktet për organizim dhe sistematizim të brendshëm të institucionit publik nga sfera e kulturës dhe aktet tjera relevante, për çfarë ai nënshkruan vërtetim për pranim i cili ruhet në dosien e tij.

Neni 77-x

Forma dhe përmbajtja e konkursit publik dhe e fletëparaqitjes për punësim, mënyra e zbatimit të audicionit, si dhe mënyra e vlerësimit me pikë në varësi të kategorisë dhe nivelit të vendit të punës për të cilin është shpallur konkursi publik, përcaktohen me akt të përgjithshëm të institucionit publik nga sfera e kulturës që e miraton Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit.

Neni 77-i

(1) Procedura për avancim ka për qëllim t'u mundësojë dhënësve të shërbimeve publike në kulturë në institucionin publik nga sfera e kulturës avancim në karrierë, përkatësisht kalim nga vende më të ulta në vende pune më të larta.

(2) Avencimi i dhënësve të shërbimeve publike në kulturë kryhet në procedurë transparente, të drejtë dhe konkurese të seleksionimit, në të cilën në bazë të vlerësimit për kontribut, profesionalizëm dhe kompetencë të kandidatëve, zgjidhet kandidati më i mirë për vend pune nga radha e të punësuarve nga ana e Komisionit për seleksionim për procedurë për avancim të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë nëpërmjet konkursit intern.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, dhënësit e shërbimeve publike në kulturë nga kategoria A mund të avancohen në procedurën e riaudicionit në pajtim me këtë ligj dhe ligjet për veprimtaritë përkatëse nga sfera e kulturës, ndërsa dhënësit e shërbimeve publike në kulturë nga kategoria D nivelet D1 dhe D2 mund të avancohen në procedurë të rizgjedhjes në tituj profesionalë në pajtim me këtë ligj dhe ligjet nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

(4) Forma dhe përmbajtja e konkursit intern, si dhe e fletëparaqitjes për avancim, mënyra e zbatimit të seleksionimit për avancim, mënyra e zbatimit të riaudicionit, si dhe mënyra e vlerësimit të tyre me pikë, përcaktohen me akt të përgjithshëm të institucionit publik nga sfera e kulturës që e miraton Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit.

Neni 77-j

Dhënësit e shërbimeve publike në kulturë kanë të drejtë në përsosje profesionale, për çfarë drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës miraton plan për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Për përsosjen profesionale mund të parashihen trajnime dhe mentori.

Neni 77-k

(1) I punësuari i epror i drejtëpërdrejtë në institucionin publik nga sfera e kulturës me status të dhënësit të shërbimit publik në kulturë është i detyruar që vazhdimisht ta ndjekë kontributin e dhënësit të drejtëpërdrejtë më të ulët të shërbimit publik gjatë tërë vitit dhe sipas nevojës të poropozojë masa për përmirësimin e të njëjtit.

(2) Vlerësimi i kontributit të dhënësve të shërbimit publik në kulturë, me përjashtim të kategorisë A niveli A1 kryhet një herë në vit dhe atë më së voni deri në 1 dhjetor për vitin rrjedhës.

(3) Vlerësimin nga paragrafi (2) i këtij neni e kryhen eprori i drejtëpërdrejtë i dhënësit të shërbimit publik në kulturë (në tekst të mëtejme: vlerësues).

(4) Vlerësuesi e vlerëson kualitetin dhe efikasitetin e punës, respektimin e afateve dhe nivelin e plotësimit të qëllimeve të punës dhe detyrave, nivelin e përfshirjes dhe përkushtimin në punë, kontributin në realizimin e programit vjetor të institucionit publik nga sfera e kulturës dhe sjelljen e tij në vendin e punës.

(5) Kriteret më të afërta për zbatimin e vlerësimit të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë nga paragrafi (2) i këtij neni, lartësia e shpërblimit në para ose lloj tjetër të shpërblimit material ose jomaterial, zvogëlimi i rrogave ose sistemimi në vend të punës në nivel më të ulët, përcaktohen me akt të përgjithshëm të institucionit që e miraton Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit.

Neni 77-II

(1) Artisëtve nga kategoria A përveç vlerësimit të kontributit nga neni 77 - k paragrafi (2) i këtij ligji, kontributi u vlerësohet me zbatimin e procedurës për riaudicion në çdo tre vjet.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, artistët nga kategoria A që kanë dhjetë vjet deri në realizimin e të drejtës së pensionit kontributi nuk u vlerësohet me zbatimin e procedurës për riaudicion .

(3) Porcedurën për riaudicion e zbaton komisioni i formuar nga drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës që përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët njëri nga rradha e artistëve të shquar të Republikës së Maqedonisë dhe katër janë artist të shquar nga jashtë.

(4) Drjetori me propozim të komisionit në afat prej pesë ditësh merr aktvendim me të cilin përcaktohet nëse artisti e ka dhënë ose nuk e ka dhënë riaudicionin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Artisti që e ka dhënë riaudicionin nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të riaudicionit, me aktvendim sistemohet në vendin e njëjtë të punës, përkatësisht mund të sistemohet në vend më të lartë të punës.

(6) Artisti që nuk e ka dhënë riaudicionin nga paragrafi (1) i këtij neni me aktvendim sistemohet në vendin e njëjtë të punës dhe është i detyruar që në afat prej gjashtë muajsh të japë riaudicion të ri. Nëse edhe pas herës së dytë nuk e kalon riaudicionin në afat prej 30 ditësh artisti me aktvendim sistemohet në vend pune tjetër më të ulët në institucionin publik nga sfera e kulturës në mënyrë përkatëse me arsimimin e tij.

(7) Në rastin nga paragrafi (6) i këtij neni për artistin i cili është sistemuar në vend pune më të ulët në afat prej gjashtë muajsh organizohet përsëri riaudicion.

(8) Nëse dhe pas herës së tretë nuk e kalon riaudicionin, drjetori miraton aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionin publik nga sfera e kulturës. Nëse e kalon riaudicionin me aktvendim sistemohet në vendin e punës në të cilin ka qenë para dhënies së riaudicionit të parë.

(9) Artisti në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të akvendimit nga paragrafët (5),(6), (7) dhe (8) të këtij neni ka të drjetë ankese në Këshillin Drejtues të institucionit publik nga sfera e kulturës.

(10) Këshilli Drejtues vendos në lidhje me ankesën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të ankesës .

(11) Kundër vendimit të Këshillit Drejtues mund të parashtrohet ankesë në gjykatën kompetente.

(12) Ankesa nuk e prolongon zbatimin.”

Neni 19

Paragrafi 78 ndryshon si vijon:

“Neni 78

(1) Dhënësit e shërbimeve publike në kulturë janë personalisht përgjegjës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës nga vendi i punës.

(2) Për shkelje të punëve dhe detyrave të punës nga vendi i punës dhënësit e shërbimeve publike në kulturë, përveç drejtorit, përgjigjen në mënyrë disiplinore.

(3) Përgjegjësia për veprën e kryer penale, përkatësisht kundërvajtjen nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të dhënësve të shërbimeve publike në kulturë.”

Neni 20

Pas nenit 78 shtohen 16 nene të reja 78-a, 78-b, 78-v, 78-g, 78-d, 78-gj, 78-e, 78-z, 78-z, 78-z, 78-i, 78-j, 78-k, 78-l, 78-l i 78-m, si vijonë:

“Neni 78-a

Dhënësi i shërbimeve publike në kulturë përgjigjet në mënyrë disiplinore për parregullsinë disiplinore dhe për shkelje disiplinore.

Neni 78-b

Parregullsia disiplinore paraqet shkelje më të lehtë të disiplinës së punës, detyrave të punës, prestigjit të institucionit publik nga sfera e kulturës ose dhënësit të shërbimeve publike në kulturë si vijon:

- 1) mosrespektim i orarit të punës, ndarjen dhe shfrytëzimin e orarit të punës,
- 2) ruajtje e parregullt e akteve, materialeve dhe të dhënave,
- 3) mosrealizim, kryerje të pandërgjegjshme, jo në kohë ose të pakujdesshme të detyrave të punës me pasoja më të lehta nga shkelja,
- 4) sjellje e pahjshme e dhënësit të shërbimeve publike në kulturë gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të punës me pasoja më të lehta nga shkelja,
- 5) shfrytëzim dhe përdorim joekonomikisht i mjeteve të ndara financiare dhe mjeteve për punë,
- 6) mosnjohim i paarsyeshëm i eprorit të drejtëpërdrejt të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, për pengesën për mosardhje në punë në afat prej tri orësh dhe
- 7) parregullësi tjera disiplinore të përcaktuara me akt të institucionit publik nga sfera e kulturës dhe marrëveshja kolektive.

Neni 78-v

Shkelja disiplinore paraqet shkelje të rëndë të disiplinës punuese, detyrave të punës, prestigjit të institucionit publik nga sfera e kulturës ose prestigjit të dhënësit të shërbimeve publike në kulturën si vijon:

- 1) moskryerje, kryerje të pandërgjegjshme, jo në kohë ose të pakujdesshme të detyrave të punës me pasoja nga shkelja,
- 2) sjellja e pahjshme e dhënësit të shërbimeve publike në kulturë gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të punës me pasoja më të rënda të shkeljes,
- 3) refuzimi i dhënies ose dhënie e të dhënave të pasakta institucioneve përkatësisht qytetarëve dhe personave juridikë, nëse dorëzimi i të dhënave është përcaktuar me ligj,

- 4) mosmarrja ose marrja jo e plotë e masave të përcaktuara për garantimin e sigurisë së lëndëve të besueshme në punë,
- 5) shkaktimi i dëmëve materiale me qëllim ose pakujdesi të skajshme,
- 6) përsëritja e parregullsisë disiplinore më shumë se dy herë gjatë vitit rrjedhës,
- 7) futja dhe përdorimi, si dhe puna nën veprimin e alkoolit ose mjeteve narkotike,
- 8) sjellje fyese ose e dhunshme në vendin e punës,
- 9) mosveprimi sipas detyrës për vlerësim të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë dhe
- 10) shkelje tjetër disiplinore të përcaktuar me akt nga institucioni publik nga sfera e kulturës dhe me marrëveshje kolektive.

Neni 78-g

(1) Me vendim për përcaktimin e parregullsisë disiplinore dhënësit të shërbimeve publike në kulturë mundet t'i shqiptohet një nga masat disiplinore në vijim:

- paralajmërim me shkrim dhe
- dënim me para në lartësi prej 20 % nga shuma njëmuajore e rrogës neto të paguar në muajin e fundit para parregullsisë disiplinore, në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj.

(2) Me vendim për përcaktimin e shkeljes disiplinore dhënësit të shërbimeve publike në kulturë mundet t'i shqiptohet një nga masat disiplinore në vijim:

- dënim me para në lartësi prej 20% nga shuma njëmuajore e rrogës neto të paguar në muajin e fundit para shkeljes disiplinore, në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj,
- sistemim në vend të punës në nivel më të ulët të drejtpërdrejtë,
- ndërprerja e marrëdhënies së punës kur kanë ndodhur pasoja të dëmshme për institucionin publik nga sfera e kulturës, e gjatë kësaj nuk janë përcaktuar rrethana lehtësuese për dhënësin e shërbimeve publike në kulturën që e ka kryer shkeljen.

(3) Gjatë shqiptimit të masave disiplinore nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni merren parasysh pesha e shkeljes, pasoja nga shkelja, shkalla e përgjegjësisë së dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, rrethanat në të cilat është bërë shkelja, sjellja e tij e mëparshme dhe kryerja e punëve, si dhe rrethana të tjera të lehta dhe të rënda që janë me rëndësi për shqiptim të masave disiplinore.

(4) Përmbledhja e dënimeve në para të shqiptuara për dhënësin e shërbimeve publike në kulturë në një muaj për parregullsi disiplinore, shkelje disiplinore dhe zvogëlimi i rrogës për shkak të kontributit të dobët nuk mund të tejkalon 30% nga shuma e rrogës së tij të përgjithshme neto për atë muaj.

Neni 78-d

(1) Masat disiplinore kundër dhënësit të shërbimeve publike në kulturë për parregullsi disiplinore i shqipton drejtori i shërbimeve publike nga sfera e kulturës, në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së raportit me shkrim nga eprori i dhënësit të shërbimeve publike në kulturë.

(2) Me përjashtim, nëse nuk ka epror të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, raportin me shkrim e përgatitë drejtori.

(3) Para shqiptimit të masës, dhënësi i shërbimeve publike në kulturën njoftohet me shkrim për provat që ekzistojnë kundër tij dhe ai ka mundësi që në afat prej tri ditësh t'i japë përgjigje me shkrim raportit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 78-gj

(1) Drejtori me aktvendim formon Komision për udhëheqjen e procedurës disiplinore për parregullsi disiplinore ose shkelje disiplinore (në tekstin më tejshëm: Komisioni disiplinor), në afat prej tetë ditëve nga dita e parashtrimit të propozimit për ngritjen e procedurës disiplinore, në të cilën në mënyrë të detyrueshme janë të përmbajtura arsyet për ngritjen e procedurës.

(2) Komisioni disiplinor përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

(3) Kryetari i Komisionit disiplinor është udhëheqës i drejtpërdrejtë i dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, ndërsa anëtarët janë dhënës të shërbimeve publike në kulturë nga të cilët njëri është përfaqësues i sindikatës, nëse ka organizatë të sindikatës në institucionin publik nga sfera e kulturës. Nëse në institucionin publik nga sfera e kulturës nuk ka të punësuar të mjaftueshëm për emërimin e komisionit disiplinor, të tjerët përcaktohen nga Ministria e Kulturës, e me kërkesë të drejtorit të institucionit publik nga sfera e kulturës.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, në institucionin publik nga sfera e kulturës në të cilin nuk ka persona udhëheqës, komisionin disiplinor e përbëjnë cilëtdo të punësuar nga institucioni publik nga sfera e kulturës.

(5) Komisioni disiplinor, në afat prej 30 ditëve duhet ta zbatojë procedurën disiplinore dhe t'i propozojë masë disiplinore përkatëse drejtorit.

(6) Nëse komisioni disiplinor konstaton se dhënësi i shërbimeve publike në kulturë nuk është përgjegjës ose nuk janë të plotësuar kushtet për miratimin e aktvendimit për shqiptimin e masave disiplinore, i propozon drejtorit, ta hedhë poshtë propozimin, përkatësisht ta ndërprejë procedurën.

(7) Drejtori, në bazë të propozimit të Komisionit disiplinor, në afat prej tri ditëve nga dita e marrjes së propozimit, miraton aktvendim për shqiptim të masës disiplinore, përkatësisht për hedhjen poshtë të propozimit, përkatësisht për ndërprerjen e procedurës.

(8) Aktvendimi për shqiptimin e masës disiplinore i dorëzohet personalisht dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, sipas rregullës në hapësirat punuese të institucionit publik nga sfera e kulturës në të cilin dhënësi i shërbimeve publike në kulturë punon, përkatësisht në adresë të vendbanim përkatësisht vendqëndrimit prej nga dhënësi i shërbimeve publike në kulturë çdo ditë vjenë në punë.

(9) Nëse dhënësi i shërbimeve publike në kulturë nuk mund të gjindet në adresën e vendbanimit, vendqëndrimit ose nëse e refuzon dorëzimin, aktvendimi shpallet në tabelën për shpallje në institucionin publik nga sfera e kulturës. Pas kalimit të tetë ditëve të punës nga dita e shpalljes së aktvendimit në tabelën për shpallje konsiderohet se dorëzimi është kryer.

(10) Kundër aktvendimit nga paragrafi (7) i këtij neni, dhënësi i pakënaqur të shërbimeve publike në kulturë ka të drejtë që në afat prej tetë ditëve të parashtron ankesë në Këshillin Drejtues të institucionit publik nga sfera e kulturës.

Neni 78-e

(1) Çdo i punësuar në institucionin publik nga sfera e kulturës dhe person tjetër, në pajtim me ligjin, ka të drejtë të parashtojë iniciativë për ngritjen e procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimeve publike në kulturë që duhet të jetë e arsyetueshme.

(2) Propozim për ngritjen e procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimeve publike në kulturë parashtron epropori i drejtpërdrejtë përkatësisht drejtori, që duhet të jetë e arsyetueshme.

(3) Propozimi nga paragrafi (2) i këtij neni i dorëzohet dhënësit të shërbimeve publike në kulturë.

Neni 78-zh

(1) Procedura disiplinore nuk mundet të ngritet nëse kanë kaluar një muaj nga dita kur eprori i drejtpërdrejtë i dhënësit të shërbimeve publike në kulturë përkatësisht drejtori, ka kuptuar për shkeljen.

(2) Procedura disiplinore nuk mund të ngritet nëse kanë kaluar tre muaj nga dita e shkeljes së bërë, përveç kur procedura disiplinore ngritet me konstatimin e revizionit të brendshëm për çfarë afati i parashkrimit është një vit.

(3) Nëse shkelja tërheq edhe përgjegjësi penale, procedura disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë së dhënësit të shërbimeve publike në kulturën, parashkruhet në afat prej dy vitesh nga dita e kuptimit të shkeljes.

Neni 78-z

Nëse dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, i pushon marrëdhënia e punës në institucionin publik nga sfera e kulturës në të cilën i është shqiptuar dënim në para, arkëtimin e dënimit të shqiptuar në para, me kërkesë të institucionit publik nga sfera e kulturës në të cilin është shqiptuar dënimi, do ta zbatojë punëdhënësi i ri ose organi kompetent në procedurën të përcaktuar me ligj.

Neni 78-x

(1) Dhënësi i shërbimeve publike në kulturë mund të suspendohet nga institucioni publik nga sfera e kulturës në bazë të aktvendimit të drejtorit.

(2) Dhënësi i shërbimeve publike në kulturën mund të suspendohet nga institucioni publik nga sfera e kulturës, në raste kur kundër atij është ngritur procedurë penale për veprën penale të kryer në punë ose në lidhje me punën ose është ngritur procedurë disiplinore për shkelje disiplinore, ndërsa shkelja është e natyrës së tillë që prania e tij e mëtejshme në institucionin publik nga sfera e kulturës deri sa të zgjat procedura, do të ndikojë në mënyrë të dëmshme mbi institucionin, përkatësisht do ta pengojë ose pamundësojë përcaktimin e përgjegjësisë për shkelje disiplinore.

(3) Suspendimi nga paragrafi (2) i këtij neni zgjat deri në miratimin e aktvendimit të plotfuqishëm përkatësisht vendimin gjyqësor.

Neni 78-i

(1) Dhënësi i shërbimeve publike në kulturë, që në punë ose në lidhje me punën, me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme do t'i shkaktojë dëm institucionit publik nga sfera e kulturës, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe është i detyruar ta kompensojë.

(2) Drejtori, me aktvendim formon Komision për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

(4) Kryetari i Komisionit është i punësuar udhëheqës në institucionin publik nga sfera e kulturës, ndërsa anëtarë janë dy të punësuar me nivel të njëjtë si dhënësi i shërbimeve publike në kulturë kundër të cilit udhëhiqet procedura e përcaktimit të përgjegjësisë materiale.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) të këtij neni, në institucionin publik nga sfera e kulturës në të cilin nuk të punësuar udhëheqës ose nuk ka të punësuar të mjaftueshëm me të njejtin nivel si dhënësi i shërbimeve publike në kulturë, komisionin e përbëjnë cilëndo tre të punësuar në institucion.

(6) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton përgjegjësinë materiale për ekzistimin e dëmit material të kryer, lartësia e tij dhe mënyra e kryerjes, kush e ka shkaktuar dëmin dhe kush do ta kompensojë.

(7) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, për përcaktimin gjendjes faktike parashtrohet raport, në bazë të së cilit drejtori miraton vendim për kompensim të dëmit.

(8) Kundër vendimit nga paragrafi (7) i këtij neni kandidati i pakënaqur ka të drejtë në afat prej tetë ditësh të parashtrojë ankesë në Këshillin Drejtues të institucionit publik nga sfera e kulturës.

Neni 78-j

(1) Propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale kundër dhënësit të shërbimeve publike në kulturë parashtrohet eprori i drejtëpërdrejtë i dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, përkatësisht drejtori.

(2) Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të ngritet, nëse kanë kaluar 30 ditë nga dita kur eprori i drejtëpërdrejtë i dhënësit të shërbimeve publike në kulturë,

përkatësisht drejtori, ka kuptuar për këtë, përveç kur procedura ngritet me konstatim të revizionit të brendshëm për çfarë afati i paeashkrimit është një vit.

(3) Perocedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të ngritet, nëse nga dita kur është bërë dëmi material ka kaluar një vit.

(4) Perocedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të udhëhiqet më gjatë se 60 ditë, duke llogaritur nga dita e miratimit të aktvendimit për formimin e Komisionit nga neni 78-i paragrafi (2) të këtij ligji.

(5) Kundër dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, që në afat prej 60 ditëve nga vendimi përfundimtar për kompensim të dëmit nuk e kompenson dëmin, institucioni publik nga sfera e kulturës ngrit procedurë para gjyqit themelor kompetent.

(6) Drejtori, mundet tërësisht ose pjesërisht ta lirojë dhënësin e shërbimeve publike në kulturë nga kompensimi i dëmit, nëse ai nuk është kryer me qëllim ose nëse me pagim të kompensimit për dëmin e bërë rrezikohet ekzistenca e dhënësit të shërbimeve publike në kulturë dhe familjes së tij ose në raste tjera të përcaktuara me marrëveshje kolektive.

(7) Mënyra e udhëheqjes së procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale, si dhe forma dhe përmbajtja e aktvendimit nga neni 78-i paragrafi (7), përcaktohen me akt të përgjithshëm të institucionit publik nga sfera e kulturës që e miraton Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit.

Neni 78-k

(1) Nëse dhënësi i shërbimeve publike në kulturë pëson dëm në punë ose në lidhje me punën, institucioni publik nga sfera e kulturës është i detyruar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet obliguese.

(2) Institucioni është i detyruar që ta kompensojë dëmin material që dhënësi i shërbimeve publike në kulturë në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës e ka shkaktuar ndaj personave të tretë.

Neni 78-l

Drejtori i institucionit publik nga sfera e kulturës, është i detyruar që në Ministrinë e Kulturës, të dorëzojë raport vjetor për masat e shqiptuara për përgjegjësinë materiale dhe disiplinore të përcaktuar të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, më së voni deri më 31 janar të vitit rrjedhës për atë paraprak.

Neni 78-l

Mënyrën e përcaktimit të rrogës themelore dhe të shtesave të rrogës të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë i rregullon themeluesi i institucionit publik nga sfera e kulturës në bazë të rregullave të përgjithshme për marrëdhënie pune.

Neni 78-m

(1) Dhënësit të shërbimeve publike në kulturë i ndërpritet marrëdhënia e punës:

- me marrëveshje,
- me kërkesë të tij,
- me fuqi të ligjit dhe
- në raste tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër dhe marrëveshje kolektive.

(2) Dhënësit të shërbimeve publike në kulturë i ndërpritet marrëdhënia e punës me marrëveshje, kur me drejtorin e institucionit publik nga fusha e kulturës, do të nënshkruajë marrëveshje me shkrim për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

(3) Dhënësit të shërbimeve publike në kulturë i ndërpritet marrëdhënia e punës në institucionin publik nga fusha e kulturës nëse parashtron kërkesë me shkrim për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

(4) Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës me kërkesë të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, afati i skadimit zgjat 30 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(5) Dhënësit të shërbimeve publike në kulturë i ndërpritet marrëdhënia e punës me fuqi të ligjit nëse:

- e humb aftësinë e punës me ditën e parashtrimit të aktvendimit të plotfuqishëm për konstatim aftësisë së humbur të punës,

- i ndërpritet shtetësia e Republikës së Maqedonisë, me ditën e parashtrimit të aktvendimit për heqje të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, nëse e njëjta është kusht për punësim,

- gjykohet për vepër penale në lidhje me detyrën zyrtare, me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- i është shqiptuar ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, me ditën e hyrjes në fuqi të aktgjykimit,

- për shkak kryerjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, me ditën e fillimit të mbajtjes së dënimit,

- mbush moshën 64 vjet, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe,

- pa arsye mungon nga puna së paku tri ditë pune të njëpas njëshme në një muaj,

- konstatohet se gjatë punësimit i ka heshtur ose ka paraqitur të dhëna të pavërteta në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për punësim,

- në afat prej tri ditëve të punës nuk kthehet në punë pas përfundimit të mungesës së papaguar për shkak të përsosjes ose aftësimi profesional,

- organi i administratës shtetërore, kompetent për mbikëqyrje inspektuese, në afat prej një viti konstaton se dhënësi i shërbimeve publike në kulturë është punësuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe

- raste tjera të përcaktuara me ligj.

(6) Aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të dhënësit të shërbimeve publike në kulturë e miraton drejtori.

(7) Aktvendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dorëzohet personalisht dhënësit të shërbimeve publike në kulturë, sipas rregullës në hapësirat e punës së institucionit publik nga fusha e kulturë në të cilën punon, përkatësisht në adresë të vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të tij.

(8) Nëse dhënësi i shërbimeve publike në kulturë nuk mund të gjendet në adresën e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit ose nëse e refuzon dorëzimin, aktvendimi paraqitet në tabelën e shpalljeve në institucionin publik nga fusha e kulturës dhe pas kalimit të tetë ditëve nga dita e shpalljes së aktvendimit, konsiderohet se dorëzimi është kryer.

(9) Kundër aktvendimit nga paragrafi (6) të këtij neni dhënësi i shërbimeve publike në kulturë ka të drejtë në afat prej tetë ditësh të parashtojë ankesë te Këshillin Drejtues i institucionit publik nga fusha e kulturës."

Neni 21

Në nenin 91-a në paragrafin (1) pas alinesë 1 shtohet dy aline të reja 2 dhe 3, si vijojnë:

“-nuk i realizon kompetencat e punëve nga neni 28 paragrafi (2) të këtij ligji (neni 28 paragrafi (2)),

- nuk parashtron raport për punën financiare të institucionit nacional dhe raport për realizim të programit vjetor për punë të institucionit nacional në afatin e përcaktuar nga neni 31-v paragrafi (1) i këtij ligji (neni 31-v paragrafi (1)).

Pas alinesë 3 shtohen pesë aline të reja 5, 6, 7, 8 dhe 9, si vijojnë:

“-nuk miraton projektprogram vjetor për punë të institucionit nacional ose nuk e parashtron projektprogram vjetor në Ministrinë e Kulturës ose nuk miraton program vjetor në pajtim me ligjin (neni 70),

- mjetet e marra nga Ministria e Kulturës i shfrytëzon pa dedikim dhe ndërmerr obligime mbi mjetet e miratuara (neni 70-a paragrafi 5),
- nuk parashtron raport për realizimin e programit vjetor për punë të institucionit nacional (neni 70-b paragrafi (2)),
- nuk zbaton audicion gjatë punësimit në pajtim me këtë ligj (neni 77-e paragrafi (2)) dhe
- nuk zbaton riaudicion në pajtim me këtë ligj (neni 77-l)."

Neni 22

Aktet e parapara me këtë ligj dhe aktet të cilat duhet të harmonizohen me këtë ligj, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 23

Drejtorët e institucioneve publike nga fusha e kulturës të zgjedhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 6 të këtij ligji vazhdojnë ta kryejnë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin janë zgjedhur.

Neni 24

Procedurat për konkurset e Ministrisë së Kulturës për financim të projekteve me interes nacional në kulturë do të përfundohen sipas dispozitave të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13 dhe 187/13).

Neni 25

Procedurat për të punësuarit në institucione nga fusha e kulturës që kanë të bëjnë me punësimin, procedurat disiplinore dhe procedurat për vlerësim, të filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundohen sipas Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13 dhe 187/13).

Neni 26

I punësuari i cili ka themeluar marrëdhënie të punës në institucion nga fusha e kulturës me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, duhet të drejtori të parashtojë dëshmi për njohje të gjuhëve të huaja dhe njohje të punës me programe kompjuterike për punë në zyre, në përputhje me nivelin e vendin e tij të punës në pajtim me këtë ligji në afat prej dy vitesh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

I punësuari i cili nuk do të parashtojë dëshmi për njohje të gjuhëve të huaja dhe njohje të punës me programe kompjuterike për punë në zyre në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, me aktvendim rroga do t'i zvogëlohet në shumë prej 10%.

I punësuari të cilit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni rroga i është zvogëluar në shumë prej 10% në çdo moment mund të parashtojë dëshmi për njohje të gjuhës së huaj dhe njohje të punës me programe kompjuterike për punë në zyre të personi udhëheqës i institucionit, i cili miraton aktvendim me të cilin aktvendimi për zvogëlimin e rrogës shfuqizohet.

Paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni nuk vlejnë për të punësuarit të cilët do ta realizojnë të drejtën e pensionit në afat prej dhjetë vitesh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 27

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për kulturë.

Neni 28

Dispozitat nga neni 6 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhëve të huaja të cilat do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Dispozitat e neneve 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 27/14).

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.